

# Forcat e punës (SASH)

(Ind = industri, Nd = Ndërtim, Treg. pak = Tregtia me pakicë dhe Sh.tj = Shërbime të tjera)

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

## Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse .....	5
5. Periudha e referencës .....	5
6. Mandati institucional.....	5
7. Konfidencialiteti .....	6
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	7
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	7
11. Manaxhimi i cilësisë .....	8
12. Rëndësia.....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	9
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	10
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	10
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	11
17. Rishikimi i të dhënave.....	11
18. Përpunimi statistikor .....	11
19. Komente.....	13
Aneks .....	13

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave Afatshkurtra
1.3. Personi i kontaktit	Olsida Spiro (Çapo)
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës në Sektorin e Statistikave Afatshkurtra
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri , ZIP Code, 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:ocapo@instat.gov.al">ocapo@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	13.03.2020
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	15.03.2019
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	13.03.2020
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Treguesit e Forcave të punës janë tregues tremujorë afatshkurtër. Burimi kryesor për dhënat e Forcave të punës është Vrojtimi tremujor i Statistikave Afatshkurtra.</p> <p>Statistikat Afatshkurtra (SASH) paraqesin një informacion shumë të rëndësishëm mbi aktivitetet ekonomike të ndërmarrjeve të zgjedhura nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve dhe klasifikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2), të cilat operojnë në Republikën e Shqipërisë. Variablat kryesore të kërkuar në lidhje me Forcat e punës janë: Numri mesatar i të punësuarve dhe Fondi i pagave.</p> <p><b>INDUSTRI</b></p> <p>Treguesit e forcave të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri mesatar i të punësuarve gjithsej</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri mesatar i të punësuarve me pagesë</li> <li>• Fondi i pagave</li> </ul> <p><b>NDËRTIM</b> Treguesit e forcave të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri mesatar i të punësuarve gjithsej</li> <li>• Numri mesatar i të punësuarve me pagesë</li> <li>• Fondi i pagave</li> </ul> <p><b>TREGTIA ME PAKICË</b> Treguesit e forcave të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri mesatar i të punësuarve gjithsej</li> <li>• Numri mesatar i të punësuarve me pagesë</li> <li>• Fondi i pagave</li> </ul> <p><b>SHËRBIME TË TJERA</b> Treguesit e forcave të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri mesatar i të punësuarve gjithsej</li> <li>• Numri mesatar i të punësuarve me pagesë</li> <li>• Fondi i pagave</li> </ul>
3.2. Sistemi i klasifikimit	Nomenklatura e përdorur për Statistikat Afatshkurtra është Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike, ( <a href="#">NVE Rev.2</a> ).
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Statistikat afatshkurtra mbulojnë të gjitha ndërmarrjet aktive në Republikën e Shqipërisë të cilat veprojnë nën aktivitetet e mëposhtme ekonomike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>INDUSTRI</b> Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara nga seksioni B tek E të klasifikimit NVE Rev.2.</li> </ul> <p>B - Industri Nxjerrëse mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 05-09  C - Industri përpunuese mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 10-33  D - Energji elektrike,gaz dhe avull mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 35  E - Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 36-39</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>NDËRTIMI</b> Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në seksionin F të klasifikimit NVE Rev.2.</li> </ul> <p>F - Ndërtimi mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 41-43.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>TREGTIA ME PAKICË</b> Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në seksionin G të klasifikimit NVE Rev.2</li> </ul> <p>G – Tregtia me pakicë mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 47.11 tek 47.78</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>SHËRBIME TË TJERA</b></li> </ul>

	<p>Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara nga seksioni G tek N të klasifikimit NVE Rev.2</p> <p>G - Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 45  G - Tregtia me shumicë mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 46</p> <p>H - Transport dhe magazinim mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 49 tek 53</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Transporti hekurudhor mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 49</li> <li>• Transporti detar mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 50</li> <li>• Transporti ajror mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 51</li> <li>• Magazinimi dhe aktivitete mbështetëse për transportin mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 52</li> <li>• Aktivitete të postës dhe korrierës mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 53</li> </ul> <p>I - Akomodimi dhe shërbimi ushqimor mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 55.10 dhe 56</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Hotel mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 55.10</li> <li>• Bar Restorant mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 56</li> </ul> <p>J - Informacion dhe komunikacion mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 58, 61 dhe 62</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitete publikimi mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 58</li> <li>• Telekomunikacioni mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 61</li> <li>• Shërbime të teknologjisë së informacionit mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 62</li> </ul> <p>M - Aktivitete arkitekturore dhe inxhinierike mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 71</p> <p>N - Agjenci udhëtimi mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 79</p>
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p><b>Numri mesatar i të punësuarve gjithsej</b>  Indeksi i numrit mesatar të personave të punësuar gjithsej ka si objektiv të tregojë zhvillimin e punësimit. Numri mesatar i të punësuarve gjithsej është përkufizuar si numri total i personave që punojnë në njësinë e vëzhguar (duke përfshirë pronarët që punojnë, partnerë që punojnë rregullisht në njësi dhe pjestarët e familjes që punojnë, por nuk paguhen), si dhe i personave që punojnë jashtë njësisë, por që i përkasin asaj dhe që paguhen nga ajo (psh. përfaqësuesit e shitjeve, personeli i shpërndarjes, skuadra e riparimit dhe e mirëmbajtjes).</p> <p><b>Numri mesatar i të punësuarve me pagesë</b>  Janë të gjithë personat që punojnë për llogari të punëdhënësit kundrejt një page për punën që kryejnë.</p> <p><b>Fondi pagave</b>  Indeksi i fondit të pagave ka për objektiv të tregojë ecurinë e kostove gjithsej të</p>

	personelit. Pagat janë përkufizuar si shpërblimi total në monedhë ose në natyrë, të paguar të gjithë personave të shënuar në listën e pagave (duke përfshirë dhe ato që punojnë në shtëpi) si shpërblim i punës së bërë gjatë periudhës së llogaritur pavarësisht nëse është paguar në bazë të kohës së punës, prodhimit apo punës me pjesë dhe nëse është paguar rregullisht ose jo).
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore është ndërmarrja.
3.6. Popullata statistikore	Popullsia statistikore përfshin njësinë statistikore, ndërmarrjet aktive në periudhën referuese, të cilat operojnë në aktivitetet ekonomike sipas NVE Rev.2, Industri (seksionet B, C,D dhe E, përkatësisht ndarjet 05-39); Ndërtim (seksioni F, ndarjet 41-43); Tregti (seksioni G, ndarjet 45-47); Shërbime (seksioni H, ndarjet 49-53; seksioni I, ndarja 55.10 dhe 56; seksioni J, ndarjet 58, 61 dhe 62; seksioni M, ndarja 71; seksioni N, ndarja 79).
3.7. Zona e referencës	Statistikat mbi Forcat e punës mbulojnë të gjithë territorin e Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Vrojtimi tremujor i Statistikave afatshkurtra referuar statistikave mbi Forcat e punës datojnë prej vitit 2003 në vazhdim.
3.9. Periudha bazë	Viti bazë: 2015 = 100, aplikohet duke filluar nga tremujori i parë 2019.
4. Njësia matëse	Njësitë matëse janë Indekset dhe Ndryshimet në përqindje.
5. Periudha e referencës	Informacioni i grumbulluar dhe përpunuar nga Statistikat Afat-shkurtra i referohet periudhave tremujore. Ky raport i përket vitit referencë 2019.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore në të cilin bazohen indikatorët e statistikave afatshkurtra konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”</a></li> <li>• <a href="#">Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021</a></li> </ul> <p>Klasifikimet dhe Përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Rregullorja e Këshillit Nr.1165 / 98</a> duke prezantuar Statistikat afatshkurtra në nivel Evropian</li> <li>• <a href="#">Rregullorja e Komisionit Nr.1503 / 2006</a> e cila përcakton variablat dhe shpeshhtësinë e përpilimit të të dhënave, shfuqizimi i porosive të reja të marra për ndërtimin e ndërtesave dhe urdhërat e reja të marra për inxhinierinë civile.</li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Nga tremujori i parë 2018 treguesit kryesorë të Statistikave Afat-shkurtra, siç janë treguesit e Forcave të punës transmetohen rregullisht në Eurostat .

## 7. Konfidencialiteti

### 7.1. Konfidencialiteti - politika

Të dhënat e mbledhura nga ndërmarrjet konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE , si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrotja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë e ofrimit të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë nënkupton kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur procesi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.

### 7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave

INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njërive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njërive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:

- a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor ose
- b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave.

Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to dhe ato të ngarkuar të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për kërkuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.

## 8. Politika e botimit

### 8.1. Kalendari i publikimeve

Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendarin. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.

8.2. Akses i kalendari e publikimeve	<a href="#">Kalendari</a> i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Akses i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias tek INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Website – online release</li> <li>• Kërkesat e shkruara</li> <li>• Publikimi</li> <li>• <a href="#">Kërkesa për të dhëna</a>, seksioni për përdoruesit e jashtëm</li> </ul>
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Treguesit e Forcave të punës shpërndahen me bazë tremujore.
<b>10. Akses i të dhënave dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	Sipas kalendarit të publikimeve, çdo tremujor publikohet njoftim për media mbi Statistikat Afat-Shkurtra (treguesit e Forcave të punës). Format i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i Statistikave Afat-shkurtra (treguesve mbi Forcat e punës) publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Rezultatet gjenden të botuara në faqen e internetit të INSTAT, nën temën: <a href="#">Statistikat Afat-shkurtra</a>
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e Statistikave Afatshkurtra. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: <a href="#">Databaza Statistikore</a>
10.4. Akses i të dhënave mikro	Të dhënat e SASH në nivel mikro nuk bëhen të disponueshme, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 7 ligji nr. 17/2018, datë 17.04.2018 "Për statistikave zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për <a href="#">Kontakt</a> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e

	nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <a href="#">Metodologjinë</a> mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave Afatshkurtra dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ATN për qëllime të brendshme.
<b>11. Manaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në përpilimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve. Kontrollat e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryhen përgjatë tërë procesit dhe më pas analizohen nga stafi me qëllim përmirësimin e cilësisë së statistikave. Stafi ka përvojën e duhur për përlogaritjen e indeksit dhe i përfshirë në faza të ndryshme të përpilimit të tij, të tilla si: mbledhja e të dhënave, kontrollat fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollat përfundimtare.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Është bërë një krahasim me të dhënat e vitit të kaluar për të parë nëse ka ndonjë koherencë të të dhënave apo nëse ka pasur ndryshime të mëdha. Në rast ndryshimesh, të dhënat administrative përdoren për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen ndryshime të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e SASH (treguesit e Focave të punës) janë klasifikuar në të jashtëm dhe të brendshëm.</p> <p>Përdoruesit e jashtëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ministrinë dhe administrata publike që përdorin të dhënat për qëllime të planifikimit të politikave ekonomike dhe sociale.</li> <li>• Universitetet (profesorë / studentë të diplomuar dhe pasuniversitar), organizata kërkimore.</li> <li>• OJQ Kombëtare dhe Ndërkombëtare</li> <li>• Ndërmarrjet</li> <li>• Publiku i gjerë që merr informacionin përmes mediave masive përmes publikimeve të bëra nga Zyra e Statistikave.</li> </ul> <p>Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Llogarive Kombëtare</li> <li>• Sektori i Regjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve</li> <li>• Sektori i Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave</li> </ul>



12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikime (Page Views) në lidhje me Statistikat Afatshkurtra për vitin 2019 janë rreth 6,132 klikime.</p> <p>Gjatë 2019 INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave Afat-Shkurtra është vlerësuar me 3.62 (72.4%) nga një shkallë prej 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë e mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit: <a href="#">Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Për sa i përket plotshmërisë së Statistikave Afat-Shkurtra, këto ndërtohen në përputhje me rregulloret e Eurostat. Shkalla e plotshmërisë së të dhënave në lidhje me treguesit e Forcave të punës, për vrojtimin e SASH 2019 është 66.7%. Kjo llogaritje bazohet duke marrë parasysh raportin e kërkesave të përmbushura nga INSTAT (rreth treguesve të Forcave të punës) kundrejt atyre që kërkohet nga rregulloret Evropiane.</p>
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime të dhënave të anketës kontrollohen me pasqyrat financiare ose me burime administrative nëse ka informacion.</p> <p>Popullata e vëzhguar e Statistikave Afat-Shkurtra 2019 përfshin afërsisht 9000 ndërmarrje për çdo tremujor. Dizanji i kampionimit është kampionim i thjeshtë i rastësishëm, i shtresëzuar. Kriteri i përdorur për shtresëzim është numri i punonjësve sipas NVE Rev.2 në nivel 3 shifror.</p> <p>Llogaritja e vlerësimeve të të dhënave statistikore dhe analiza e njesive outlier kryhet rregullisht. Shkalla e saktësisë së përgjithshme është e lartë, duke marrë parasysh shkallën e lartë të përgjigjes. Për të llogaritur vlerësimet, përdoret vlerësuesi Horvitz-Thompson, që është i paanshëm. Saktësia e vlerësimeve arrihet duke eliminuar gabimet e kampionimit dhe të jo kampionimit, të tilla si mbulimi, pa përgjigje, gabimet e përgjigjes dhe gabimet e përpunimit.</p> <p>Arsyet e shfaqes së gabimeve në mbulim janë keq klasifikimi i njësive dhe ndryshimet në statusin e njësive raportuese. Është e detyrueshme t'i përgjigjes vrojtimit. Në rast mos-përgjigje, njësitë kontaktohen përmes telefonit dhe postës elektronike. Gabimi në kampionim në përqindje (CV) llogaritet për treguesit kryesorë të vrojtimit që publikohen çdo tremujor.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Gabimet e kampionimit trajtohen në raportet e brendshme teknike, ku për çdo indikator në vrojtimit llogaritet varianca e totalit, si dhe gabimi standart relativ, për eliminimin e efektit negativ që jep lëvizja e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes në serinë kohore të vlerave. Të gjitha vlerat e treguesve përgjithësohen për të përfaqësuar gjithë popullatën në studim.</p>
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Gabimet jo për shkak të kampionimit për treguesit e Forcave të punës janë kryesisht për shkak të gabimit të mos-përgjigjes. Mos-përgjigja në nivel rekordi</p>

	<p>merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën.</p> <p>Prandaj, sektori i Statistikave Afatshkurtra shfrytëzon të dhënat administrative dhe teknika të mira të vlerësimit kur është e nevojshme.</p>
--	--

#### 14. Afatet kohore dhe përpikmëria

14.1. Afatet kohore	<p>Treguesit e Forcave të punës për 2019 janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 73 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T+73 ditë). Periudha referuese e rezultateve është 31 Dhjetori 2019.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2019</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/13/2020</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>73</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2019	Data e publikimit	3/13/2020	Afatet kohore	73
Periudha referuese	12/31/2019						
Data e publikimit	3/13/2020						
Afatet kohore	73						

14.2. Përpikmëria	<p>Treguesit e Forcave të punës publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i rezultateve mbi Treguesit e Forcave të punës ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2019</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>3/13/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/13/2020</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2019	Data e shpallur	3/13/2020	Data e publikimit	3/13/2020	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2019								
Data e shpallur	3/13/2020								
Data e publikimit	3/13/2020								
Vonesa në kohë	0								

#### 15. Koherenca dhe Krahasueshmëria

15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Të dhënat mbi treguesit e SASH, siç janë treguesit e Forcave të punës janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e Eurostat dhe si të tilla janë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. Të dhënat janë gjithë përfshirëse dhe prodhohen në nivel vendi.</p>
-----------------------------------	---

15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Ndër vite Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve në SASH ka pësuar ndryshime në fushën e mbulimit dhe në metodën e zgjedhjes. ATN ka filluar për herë të parë në vitin 2003. Në vitin 2005 është shtuar aktiviteti i Tregtisë me shumicë. Në vitin 2008 metoda e kampionimit kalon nga metoda me listim në metodën e kombinuar (me kampionim dhe listim). Ndërmarrjet më 1-9 të punësuar janë me kampionim, ndërsa ndërmarrjet me mbi 10 të punësuar janë marrë me listim (në mënyrë ekzostive) pa ndryshuar fushën e mbulimit. Në vitin 2012 ndryshon popullsia e ATN si rezultat i përditësimit të Rregjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve me rezultatet e Rregjistrimit të Ndërmarrjeve Ekonomike, 2010. Në vitin 2014 në SASH implementohet Nomenklatura e Re e Aktiviteteve Ekonomike, NVE REv.2, përditësohet struktura e peshave dhe ndryshon periudha bazë e indekseve nga 2005 në 2010.</p> <p>Në vitin 2019 në SASH përditësohet struktura e peshave dhe ndryshon periudha bazë e indekseve nga 2010 në 2015. Në të gjitha këto ndryshime seritë e indekseve nuk janë shkëputur, por indekset janë përditësuar për të reflektuar ndryshimet. Të gjitha ndryshimet janë raportuar në Shpjegimet metodologjike që shoqërojnë publikimet përkatëse.</p>
------------------------------	--

15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Të dhënat kontrollohen me burimet administrative me bazë tremujore. Pas këtyre kontrolleve mund të konkludohet se të dhënat janë koherente.
15.4. Koherenca e brendshme	Koherenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar përpara se ato të finalizohen. Lidhja midis variablave është kontrolluar dhe koherenca midis serive të ndryshme të të dhënave është konfirmuar. Specialistët e Statistikave afatshkurtra punojnë së bashku me specialistë të drejtorive përkatëse për të siguruar qëndrueshmërinë dhe koherencë të treguesve statistikor.
<b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b>	<p>Kostoja e Statistikave Afatshkurtra përfshin informacion mbi numrin e stafit të përhershëm dhe të përkohshëm. Numri i stafit të ATN është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Totali i stafit në Zyrën Qendrore: 3 punonjës</li> <li>• Specialistët e logjistikës 1 të punësuar</li> <li>• Kontrollorë (4 muaj) 2 të punësuar</li> <li>• Operatorë (4 muaj) 2 të punësuar</li> </ul> <p>Për trajtimin e mos përgjigjes përdoren të dhënat administrative për imputim të cilat janë falas. Marrëveshja e bashkëpunimit është nënshkruar midis INSTAT, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në mënyrë që transmetimi i të dhënave administrative të mundësohet pa kosto. Burimet Statistike si (Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ATN e mëparshme) janë gjithashtu pa kosto, pasi janë konsideruar si përdorues të brendshëm. Stafi i ATN menaxhon kontrollin dhe analizën e të dhënave, kështu që edhe këto dy procese nuk kanë kosto të tjera shtesë.</p>
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të ATN bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e revizionimit</a></li> <li>• <a href="#">Politika e trajtimit të gabimeve</a></li> </ul>
17.2. Praktika e rishikimit	Të dhënat e publikuara nuk konsiderohen përfundimtare ato mund të rishikohen. Të dhënat mund të rishikohen për një sërë arsyesh si: implementimi i klasifikimit të ri NVE, ndryshime metodologjike, burime të reja informacioni ose të përmirësimeve të të dhënave dhe korrigjime të gabimeve. Rishikimi i tremujorit paraardhës është i mundur të kryhet gjatë çdo tremujori dhe në fund të çdo viti mund të kryhen korrigjime për të katërt tremujorët.
<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	Të dhënat mbi statistikën Afat-Shkurtra bazohen në anketat statistikore tremujore. Baza e përzgjedhjes është Regjistri i ndërmarrjeve aktive për vitin referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve bëhet sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike, NVE Rev. 2. Popullata në studim përcaktohet nga dy kritere

	<p>themelore: Madhësia e ndërmarrjes (bazuar në numrin e të punësuarve) dhe aktiviteti ekonomik brenda fushës së studimit, me prerje. Metoda e përzgjedhjes së përdorur është Përzgjedhje e thjeshtë e Rastit me Shtresëzim (SRS). Shtresëzimi bazohet në kombinimin e aktivitetit ekonomik me grupin e madhësisë së ndërmarrjes. Treguesit janë paraqitur për aktivitete ekonomike sipas fushave të përcaktuara në rregulloren e Statistikave Afat-Shkurtra dhe gjithashtu bazuar në nevojat e përdoruesve.</p>
18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat mblidhen çdo tremujor.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat grumbullohen me intervistim të drejtpërdrejtë me pyetësor me letër çdo tremujor, 15 ditë pas mbylljes së tremujorit referues. Kohëzgjatja në terren është 15 ditë pune.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Të dhënat e marra nga vrojtimi dhe nga skedari i Listë pgesës (i përdorur për imputim) vlerësohen duke përdorur rregulla logjike të vlefshme. Në nivel kombëtar, editimi përfshin studimin e të dhënave të të anketuarve me qëllim identifikimin (dhe korrigjimin) e gabimeve. Jo të gjitha gabimet mund të identifikohen, por qëllimi është të zbulohen ato gabime që kanë ndikim të madh tek rezultatet. Rregullat për identifikimin e gabimeve mund të vënë në dukje gabime të mundshme të cilat kërkojnë një studim të mëtejshëm për të kuptuar se ku qëndron gabimi përkundrejt një rezultati të pazakontë ose mund të evidentojnë gabime të përcaktuara. Redaktimi (editimi) përfshin kontrollë për tërësinë, që vlerat janë brenda kufijve të caktuar dhe se vlerat për variablat e lidhur janë koherent. Redaktimi i të dhënave mund të bëhet gjatë ose pas hedhjes së të dhënave. Përgjigjet mund të krahasohen me përgjigjen e tremujorëve të mëparshëm. Mospërputhja ose devijimet e mëdha (jashtë një diapazoni të paracaktuar) tregojnë se një studim më i thellë do ishte i rëndësishëm. Kjo mund të rezultojë në redaktim të dhënash. Në kontekstin e afatit kohor, procesi i redaktimit mund të jetë i dizajnuar për t'i dhënë përparësi kryesore atyre njesi outlier që kanë më shumë nevojë për redaktim për hir të aggregateve të besueshëm. Me zgjidhjen e rasteve më të këqija, mund të arrihen përmirësime të mëdha.</p>
18.5. Përpilimi i të dhënave	<p><b>Nivel Kombëtar</b></p> <p>Hapi i parë është mbledhja e informacionit direkt i mbledhur nga anketuesit. Qëllimi është për të sjellë këtë informacion në nivelin statistikor. Proçesi i ndjekur është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli fizik i pyetsorëve (verifikimi i plotësimit të pyetsorëve sipas standarteve të skanimit)</li> <li>• Kontrolli logjik i pyetsorëve (kontrolli i shënjitimit logjik të indikatorëve të përgjigjes, përshkrimit të aktivitetit dhe kodifikimit si dhe kontrolli i plotësimit të shifrave)</li> <li>• Pas hedhjes së të dhënave, gabimet dhe mospërputhjet evidentohen dhe korrigjohen përgjatë redaktimit (editimit).</li> <li>• Mos-përgjigjet dhe mungesa e informacionit për ndërmarrjet e rëndësishme (ndërmarrjet e mëdha) duhet të plotësohen nëpërmjet proçesit të imputimit duke përdorur informacionin e marrë nga burime të tjera.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krahasueshmëria e të dhënave (ndërmjet të dhënave të vrojtimit dhe të dhënave administrative, periudhat e mëparshme ose trendet).</li> <li>• Analiza e rezultateve për çdo fushë publikimi (domein).</li> <li>• Rezultatet e plota dhe të pastra të të dhënave shërbejnë më pas për fazën e peshimit dhe ri-peshimit</li> <li>• Të dhënat e agreguara krahasohen me të dhëna nga burime të tjera</li> <li>• Dy fazat e fundit mund të jenë subjekt analizash të tjera, në funksion të rezultateve sipas fushave të publikimit (domein-et).</li> </ul> <p>Së fundi, kur analiza statistikore ka përfunduar, këto të dhëna përcaktohen si grup informacioni jo-publike. Para shpërndarjes së rezultateve, fazë shumë e rëndësishme është ruajtja e konfidencialitetit të këtij informacioni.</p>
18.6. Rregullimi	Asnjë rregullim (përshtatje sezonale) nuk është bërë për variablin e punësimit dhe variablin e fondit të pagave.
<b>19. Komente</b>	Kjo metadatë bashkon të gjitha variablat që lidhen me Punësimin (punësimin dhe fondin e pagave) për të gjitha fushat e SASH (Industri, Ndërtim, Tregtia me pakicë dhe Shërbime).
<b>Aneks</b>	